



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.834/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Banana” O.P. me seli në Istog, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K., avokate në Prishtinë kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti Fiskal, KF.nr.328/22, të datës 02.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Banana” O.P. me seli në Istog, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti Fiskal, KF.nr.328/22, të datës 02.05.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti Fiskal, KF.nr.328/22, të datës 02.05.2023, Në pikën I. të dispozitivit është refuzuar kërkesëpapia e paditësit Banana O.P. me seli në Istog, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K., avokate në Prishtinë, si e pa bazuar. Në pikën II. Është lënë në fuqi vendimi nr. 30/2021 i datës 18.02.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë. Ndërsa, në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësueses së autorizuar, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës LPK-së dhe LKA-së, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë, duke e aprovuar këtë ankesë ta ndryshojë aktgjykimin e goditur ashtu që të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit ose ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në Dhomën e Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.30/2021 i datës 18.03.2021 të Administratës Tatimore të Kosovës - Departamentit të Ankesave, nën pikën I të

dispozitivit të vendimit është refuzuar si e pa bazë ankesa nr.159/2019 e datës 12.04.2019 e subjektit “Banana” O.P. me numër të regjistrimit fiskal (NRF): 600153564, me seli të biznesit në rrugën “Lidhja e Prizrenit” në Istog, në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nën pikën II të dispozitivit, Vendimi nr. 0330/2019 i datës 12.03.2019 në vlerë prej 1,000.00€, lëshuar nga Zgjona e Administratës Tatimore e Kosovës në Prishtinë, vërtetohet si e bazuar.

Paditësi i pa kënaqur me ndëshkimin nga e paditura Administrata Tatimore e Kosovës-Departamentit të Ankesave, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 25.03.2021, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.30/2021 të datës 18.03.2021, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga dokumenti i titulluar “*formë për vizitë përmbushëse e datës 28.02.2019*” dhe “*regjistrimi i stoqeve i datës 28.02.2019 sipas formave AU03*”, ka vlerësuar si të drejtë konstatimin e të paditurit se tatimpaguesi këtu paditësi nuk ka qenë i rregullt në mbajtjen e evidencave lidhur me stoqet momentale, dokumente këto të nënshkruara si të tilla edhe nga këtu përfaqësuesi i paditësit në kohën e realizimit të vizitës, dhe se me këtë fakt të konstatuar të mungesës së stokut ka rrjedh baza për aplikim të shitjes së detyrueshme e rrjedhimisht edhe për konstatim të qarkullimit shtesë në këtë shumë si dhe për ndëshkim administrativ për mos mbajte të librave dhe regjistrimeve në pajtim me legjislacionin në fuqi, respektivisht të nenit 52, par 2.4 të Ligjit 03/L-222. Tutje këtu paditësi nuk ka dëshmuar as para gjykatës por as në procedurë të ankesave pranë Departamentit të Ankesave në ATK-ë, fakte mbështetëse të pretendimit për gjobën mandatore prej 1,000.00 euro të shqiptuar nga i padituri me vendimin nr. 0330/2019 datë 12.03.2019 dhe vërtetuar edhe me vendimin nr. 30/2021 datë 18.02.2021, për faktin se e njëjta rrjedh nga konstatimi i gjendjes faktike (mungesa e konstatuar e stokut me datë 28.02.2019, si më lartë, e që lidhet me mos mbajtjen e librave dhe regjistrimeve siç kërkohet edhe me dispozitat e nenit 13, paragrafi 4 dhe 5, të ligjit 03/L-222, dhe të dispozitave të nenit 17 dhe 18 par.1 të UA 15/2010, paragrafi 2. Nuk mjafton që paditësi pretendimet lidhur me gjobën mandatore, vetëm ta cek si të tillë në padi por pa i mbështetur me fakte dhe prova konkrete, sepse gjykata vepron vetëm në bazë të fakteve dhe provave të administruara në shqyrtim gjyqësor, andaj edhe me të drejtë i padituri komfor gjendjes faktike të konstatuar të datës 28.02.2019 dhe të dispozitave si më lartë, ka refuzuar kërkesën e tatimpaguesit këtu paditësit, në procedurë të ankesës. Nga kjo gjendje faktike, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është

përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, pasi që aktgjykimi i ankimuar është i paqartë, në kundërshtim me vetveten, me faktet vendimtare dhe me provat e administruara. Këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Po ashtu sa i përket pretendimi t se inspektorati nuk ka bërë verifikimin e të gjitha stoqeve në të gjitha vend ndodhjen e tyre, meqë disa prej artikujve janë numëruar vetëm në depo e jo edhe në objektet e Banana Center, kolegji këtë pretendim e vlerësoj si të pa qëndrueshëm për faktin se paditësi nuk ka dëshmuar pranë gjykatës e as në procedurë të ankesave pranë të paditurës fakte që do të vërtetonin një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar me datë 28.02.2019 ku ka rezultuar me mungesë të stokut dhe parregullsi të konstatuara për shkak të mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve, andaj me këtë rast paditësi ka vepruar në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-222 dhe për këto shkelje është ndëshkuar me nenin 53 paragrafi 2. pika 2.4 i Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë përveç që ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave që ka rezultuar me konstatim të gabuar të gjendjes faktike e të gjitha këto kanë ndikuar që të nxirret një aktgjykim i paligjshëm. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ka qenë obligim i palës të prezantoj para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij si dhe një përmbledhje të arsytimit ligjor dhe faktik të ankesës- padisë ashtu siç parashihet me nenin 81.E paragrafi 4 pika 4 dhe 5 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Administratës Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë nga kjo formë e vizitës, me të drejtë ka konstatuar se kontrolli tatimor vendimin e vet e ka mbështetur në dispozitat e nenit 53 paragrafi 2. pika 2.4 i Ligjit nr. 03/L-222 për shkak të shkeljeve ligjore nga neni 13 paragrafi 1 dhe 4 i Ligjit 03/L-222 nenit 17 pika 2.6 e Udhëzimit Administrativ 15/2010. Andaj, kolegji vlerëson Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se vendosja e ndëshkimit përcakton gjendjen e konstatuar në momentin e caktuar kohor ku në këtë rast paditësi nuk ka qenë i rregullt në mbajtjen e evidencave lidhur me stoqet momentale, dhe nga ky fakt e të nënshkruar dhe pranuar edhe nga përfaqësuesi i paditësit janë konstatuar mungesë të stokut dhe nga kjo ka rrjedh edhe baza për aplikim të shitjes së detyrueshme e rrjedhimisht edhe për konstatim të qarkullimit shtesë në këtë shumë si dhe për ndëshkim administrativ për mos mbajtje të librave dhe regjistrimeve në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes kolegji i kësaj gjykate gjen se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka mundur që të pranoj pretendimet e paditësit për të ndryshuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga inspektori tatimor. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë e ka konsideruar si të drejtë aktvendimin e kontestuar të paditurës, me të cilin është refuzuar ankesa e subjektit “Banana” O.P. me seli në Istog, e ushtruar kundër vendimit nr.30/2021 të datës 18.03.2021, me të cilin vendim paditësi është ndëshkuar me gjobë mandatore në shumë prej 1,000.00€, pasi që sipas aktivitetit të vizitës përmbushëse nga regjistrimi fizik i mallrave në stoqe në bashkëpunim me paditësin, e paditura ka vërtetuar gjendjen faktike në momentin e caktuar kohor të gjendjes së stoqeve në lokacionin e paditësit sipas formave AU03. Prandaj, nga kjo gjendje rezulton se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nenit 44 të LKA-së, si dhe Udhëzimit Administrativ nr.15/2010. Po ashtu, sipas vlerësimit të kolegjit, aktgjykimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.834/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami